

## 10.2 TRANSFERIMI I KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKËS PËRMES KUJTESËS SË PËRKOHSHME

Metoda e transferimit të koleksioneve të bibliotekës përmes kujtesës së përkohshme përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme, këtë e bëni kur dëshironi që në modulën e programit COBISS2/Katalogimi të përdorni komandën *RENAME-TO* të regjistrimit, i cili përmban të dhënat për koleksionet e bibliotekës. Në rastin e tillë procedura është si në vazhdim:

- në modulën e programit COBISS3/Koleksionet e bibliotekës, transferoni të dhënat për koleksionet e bibliotekës nga regjistrimi bibliografik në kujtesën e përkohshme
- në bazën bibliografike lokale të të dhënave (në modulën e programit COBISS2/Katalogimi) përdorni komandën *RENAME-TO*,
- në modulën e programit COBISS3/Koleksionet e bibliotekës, ktheni të dhënat për koleksionet e bibliotekës nga kujtesa e përkohshme në regjistrimin bibliografik.

Transferimi i koleksioneve të bibliotekës të regjistrimit për materialin që është në huazim ose i rezervuar, mund të kryhet vetëm në rastin e vendosjes së parametrave specialë në skedarin e konfigurimit.

---

### 10.2.1 Transferimi i fushave 996/997 dhe 998 në kujtesën e përkohshme

Transferoni të dhënat për koleksionet e bibliotekës nga regjistrimi bibliografik në kujtesën e përkohshme.

#### ***Kushti***

Kujtesa e përkohshme duhet të jetë e zbrazët.

#### ***Procedura***

1. Në klasën **Materiali**, kërkoni dhe përzgjidhni materialin.
2. Përzgjidhni metodën **Objekti / Transfero fushat 996/997 dhe 998 në kujtesën e përkohshme**.  
Do të shfaqet porosia për statusin e materialit në huazimit.
3. Klikoni butonin **Në rregull**.  
Do të shfaqet pyetja, nëse dëshironi të vazhdoni transferimin e fushave.
4. Pasi të klikoni butonin **Po**, të gjitha fushat do të transferohen në kujtesën e përkohshme.

---

## 10.2.2 Kthimi i fushave nga kujtesa e përkohshme

Pasi të përdorni komandën *RENAME-TO*, të dhënat për koleksionet e bibliotekës mund t'i transferoni nga kujtesa e përkohshme në regjistrimin bibliografik me ID të ri të COBISS.XX.

### *Procedura*

1. Në klasën **Materiali**, kërkoni dhe përzgjidhni materialin.
2. Përzgjidhni metodën **Objekti / Kthe fushat 996/997 dhe 998 nga kujtesa e përkohshme**.  
Do të shfaqet pyetja, nëse dëshironi të vazhdoni transferimin.
3. Pasi të klikoni butonin **Po**, të gjitha fushat do të transferohen në regjistrimin bibliografik.

---

## 10.2.3 Shfaqja e fushave në kujtesën e përkohshme

Listën e fushave, të cilat i keni transferuar në kujtesën e përkohshme mund edhe t'i shihni.

### *Procedura*

1. Përzgjidhni klasën **Fusha 996/997**.
2. Përzgjidhni metodën **Klasa / Shfaq fushat 996/997 dhe 998 në kujtesën e përkohshme**.  
Do të hapet dritarja duke shfaqur fushat 996/997.
3. Klikoni butonin **Mbyll**.  
Do të hapet dritarja duke shfaqur fushën 998.